

Emri i Lëndës : Variante të Anglishtes							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
ELL 311	B	Vjeshtë	3.00	0.00	0.00	3.00	5.00
Lektori		Arti Omeri, PhD					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Anglisht					
Niveli i lëndës		Bachelor					
Përshkrimi		Lënda e sheh zhvillimin e gjuhës Angleze nga pikëpamja historike, dhe është gjithashtu një studim i varianteve të Anglishtes në botën moderne e cila mbulon dialektet, gjuhën kreole, përdorimin e lingua franka dhe vendodhjet gjeografike të Anglishtes si gjuhë e parë dhe gjuhë e dytë. Do të krahasohen edhe shqiptimet e Anglishtes standarte Britanike me Anglishten e Amerikës dhe Kanadasë.					
Objektivat		Studentët do të mësojnë zhvillimin historik kronologjik të Anglishtes, shndërrimin e saj në një lingua franka, dhe përdorimin e saj sinkronik në botën moderne. Do të theksohen aplikimet gjuhësore në botën reale, dhe të dhënat do të mblidhen nga informatorët dhe nga burime të tjera, dhe do të prezantohen në klasë në grupe dyshe ose në skuadra.					
Konceptet Kryesore		Variantet e gjuhës Angleze Dialektet Anglishtja në bote Anglishtja në Amerikën e Veriut Anglishtja në Mbretërinë e Bashkuar					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Historia e gjuhës Angleze Kapitulli i parë është rreth historisë së gjuhës Angleze. David Crystal përlogarit se janë rreth 400 milion njerëz që e kanë Anglishten si gjuhë të parë, dhe në total janë 1.5 miliard njerëz që e flasin pak a shumë rrjedhshëm gjuhën Angleze. (fq. 1-21)						
2	Historia e gjuhës Angleze Dy shtetet me të mëdha përtaqëse të popullsisë ku do të vezhgohet gjuha Angleze dhe ku Anglishtja është gjuhë e trashëguar kombëtare janë Britania dhe SHBA. Gjithashtu Anglishtja është gjuhë e shumices në Australi dhe në Zelandën e Re dhe gjuhë kombëtare në Kanada dhe Afrikën e Jugut. Për më tepër Anglishtja është gjuhë e dytë në disa vende, ndërsa në disa të tjera gjuhë zyrtare apo gjuhë e biznesit. (fq. 21-42)						
3	Fonetika dhe Morfologjia Një efekt i dukshëm gjuhësor i gjuhës Angleze që vjen si pasojë e zgjerimit kolonial ishte afrimi i huazimeve të marra nga një shumëllojshmëri gjuhësh. (fq. 43-75)						
4	Fonetika dhe Morfologjia Variantet gjuhësore janë të njohura në komunitetet gjuhësore. Për shembull, shumë variante të Anglishtes kanë alternativa shqiptimi [iðə] dhe [æðə] për fjalën either, pa i bashkuar ndonjë grup shoqëror sejcilit variant. (fq. 76-109)						
5	Sintaksa Ky kapitull është një përmbledhje e historisë së sintaksës së gjuhës Angleze. Do të diskutohen ndryshimet kryesore dhe aty ku është e mundur do të thuhet diçka rreth faktorëve që luajtën një rol për ndryshimet dhe ndikimin e ndryshimeve individuale. Në fillimet e saj Anglishtja ishte një gjuhë shumë e lakueshme me një renditje të lirë fjalesh dhe me një bazë leksiku kryesisht me fjale nga gjuha Gjermane, pak a shumë si gjuha Gjermane sot. (fq. 110-199)						
6	Fjalori Shumë ndryshime në fjalorin e gjuhës Angleze janë si shkak i huazimeve të shumta nga gjuhët me të cilat gjuha Angleze ka pasur kontakt përgjatë historisë, formimi i fjaleve dhe ndryshimi i kuptimit të fjaleve. (fq. 200-271)						
7	Standardizimi Milroys e përcakton standardizimin si shtypje të varianteve të mundshme të gjuhës, duke vezhguar se disa etapa të ndryshme janë zakonisht të përfshira në zhvillimin e një gjuhe standarde të cilat mund të përshkruhen si pasojë e një nevojë për njësim e cila ndihet nga një pjesë me peshe në shoqëri në një kohë të caktuar’ (1991: 27). Në implementimin e këtij zhvillimi identifikohen disa faza: selection, acceptance, diffusion, maintenance, elaboration of function, codification dhe prescription. (fq. 272-311)						

8	Provim Gjysmëfinal Studentet duhet të dorezojnë me email projektin gjysmefinal të cilin ata e kanë përgatitur.
9	Emrat Emrat janë një perkufizim teknik për një nëngrup shprehjesh të një gjuhe të cilët përdoren për t'u referuar (identifikojnë apo përzgjedhin në një kontekst) dhe në disa raste përdoren për të adresuar një partner në komunikim. Shprehjet emerore kryesisht paraprihen nga emrat. . (fq. 312-351)
10	Anglishtja në Britaninë e Madhe Në mund të njohim thjesht shtetet dhe të flasim rreth gjuhës Angleze, Skoceze, Uellsiane dhe dialektet Irlandeze. Por mjafton vetëm një moment për të kuptuar se nuk do ta bëjmë këtë gjë. Një folës i gjuhës në Kent nuk e shikon dialektin e tij të njëjtit me dike në Newcastle, ashtu siç edhe folësit nga Aberdeen dhe Glasgow nuk mendojnë se flasin dialekt të njëjtit. (pp. 352-370)
11	Anglishtja në Britaninë e Madhe Folesit ndryshojnë në moshe, gjini, shtrese shoqërore dhe me shumë në etni. Kështuqë folësit nga e njëjta zonë gjeografike duhet të ndryshojnë nga njëri tjetri për shkak të moshës, gjinisë dhe ndryshimeve të tjera shoqërore. (fq. 371-383)
12	Anglishtja në Amerikën e Veriut Në 1607, pas disa përpjekjeve të deshtuara Anglezët patën sukses në Jamestown, Virginia, me vendbanimet e para të përhershme në botën e re. Në dekadat në vazhdim disa vendbanime të tjera Angleze u bënë në gjirin e Massachusetts, Plymouth, Providence dhe vende të tjera. (fq. 384-400)
13	Anglishtja në Amerikën e Veriut Përtej Atlantikut, zbuluesit dhe banorët u takuan, u përzier dhe ndonjëherë u martuan me Amerikanët amëtar dhe përdoren emrat e tyre për shumë punime në jetën dhe kulturën e tyre, ashtu edhe për vendet si dhe për bimët dhe kafshët e panjohura në mjedisin e ri. Për vendet dhe gjërat e tjera folësit e Anglishtes shpiken emra të rinj ose vendosen emra që njihnin. (fq. 401-420)
14	Anglishtja në Botë Njëzetit e kanë parashikuar berjen e gjuhës Angleze një gjuhë globale të pakten dy shekuj me parë (shih Bailey, 1991: ch. 4), por në kuptim të vertetë global ky fenomen është i ri. Një gjuhë e fiton statusin e vertetë global kur zhvillon një rol të vecantë që njihet në të gjitha shtetet. fq. 421-439)
15	Përsëritje Jven e fundit do të bëhet përsëritje e kapitujve të mëparshëm dhe studenteve do t'u jepet feedback për projektin e tyre final.
16	Provimi Final
Parakushtet	
Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.	
Literatura	
• RICHARD HOGG AND DAVID DENISON (2006). A History of the English Language, Cambridge University Press 2006	
Referenca të tjera	
• Wright, L.(2000). The development of Standard English, Cambridge University Press.	
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Studentet do të marrin njohuri mbi Anglishten standarde të Britanisë, Amerikës
2	Studentet do të marrin njohuri kronologjike mbi zhvillimet historike të Anglishtes, dhe mundësi për të ndjekur zhvillimin e gjuhëve të tjera.
3	Studentet do të marrin njohuri të përdorimit sinkronik dhe zhvillimeve të fundit të Anglishtes si lingua franca në botën moderne.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	35	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	10	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			45
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			55
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	3	42
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	15	15
Provimi final	1	20	20
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			125
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5.00
ECTS			5.00